



**Promovimi i Biçikletës për të gjithë
si Mënyrë e Përditshme Transporti**

Cycling: a daily transport
mode for everyone

**SHTYSE për
PEDALIMIN**

**PRESTO Udhëzues i Politikës së
Pedalimit**

Infrastruktura e Biçikletës

Intelligent Energy  **Europe**



PRESTO

Udhëzues i Politikës së Pedalimit
Infrastruktura e Bëqikletës

PRESTO Udhëzues i Politikës së Pedalimit Infrastruktura e B biçikletës

Ky udhëzues është botuar në kuadër të projektit “TEUTA” që zbatohet nga organizata GO2, si pjesë e programit ACHIEVE “Shoqëri Civile Shqiptare për një Mjedis Evropian” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e GO2 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian apo dhe të REC Shqipëri.



Organizatë për Lëvizje të Qëndrueshme Urbane
Sustainable Urban Mobility Organization

Blv. “Skënderbeu”, Nd.34, H.2, Ap.1
4001 Shkoder Albania
+355(0)696728877
+355(0)695590290
info@go2albania.org
www.go2albania.org



Dy fjalë mbi Udhëzuesin e Infrastrukturës së Biçikletës

Ky udhëzues në gjuhën shqipe ka për qëllim t'u shërbejë ekspertëve të planifikimit, trafikut dhe transportit pranë qeverisjeve qendrore dhe lokale dhe jo vetëm, qofshin ato në Shqipëri, Kosovë dhe treva të tjera shqipfolëse.

Përmes këtij udhëzuesi, njohja me biçikletën dhe infrastrukturën e saj synohet të bëhet më e lehtë dhe më e qasshme. Publikimi në versionin shqip bëhet në kuadër të Planit të Lëvizjes së Qëndrueshme Urbane për Bashkinë e Shkodrës, falë projektit TEUTA, të zhvilluar nga GO2 në bashkëpunim me Bashkinë e Shkodrës dhe IPM, financuar nga Komisioni Europian dhe koordinuar nga REC Shqipëri. Ky është i pari plan i tillë në Republikën e Shqipërisë.

Falenderime për znj. Maniela Sota, z. Besmir Vokopola, si dhe për të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij udhëzuesi.

Entela Shkreli
GO2

Projekti

PRESTO (Promoting Cycling for Everyone as a Daily Transport Mode) është një projekt i Programit European - EU's Intelligent Energy, i financuar nga Agjensia Ekzekutuese për Konkurrencë dhe Risi (EACI).

Partnerët

Rupprecht Consult GmbH, Gjermani
Federata e Pedaluesve Europeanë, Belgjikë
Shoqata Europiane e Tregtimit të dy-Rrotakëve, Belgjikë
Ligtermoet & Partnerët, Hollandë
Promovimi i Lidhjeve Operacionale me Shërbimet e Integruara, Belgjikë
Europa e përbashkët e Shoqatës së Pomeranisë, Poloni
Federata e Pedaluesve Gjermanë Bremen, Gjermani
Free Hanseatic City of Bremen, Gjermani
Alpet Metropolitane Grenoble, Francë
Qyteti i Tczew, Poloni
Qyteti i Venecias, Itali
Qyteti i Zagrebit, Kroaci

Koordinatorë Projekti

Siegfried Rupprecht, Rafael Urbanczyk, Michael Laubenheimer
Rupprecht Consult GmbH, Cologne, info@rupprecht-consult.eu

Menaxherë Propagandimi të Projektit

Florinda Boschetti, European Cyclists' Federation, Bruksel, f.boschetti@ecf.com

Autorë

Dirk Dufour, Ligtermoet & Partners, Hollandë

Shkurt 2010

Versionet gjuhësore

Originale: anglisht

Përkthimi: shqip

Përkthime (akoma të parealizuar): gjermanisht, frëngjisht, polonisht, italisht, kroatisht

Ky version në anglisht mund të gjendet në www.presto-cycling.eu

Nëse dëshironi të keni një version të dizenuar të udhëzuesit, ju lutem dërgoni një e-mail në f.boschetti@ecf.com dhe do ta merrni atë sa më shpejt të jetë e mundur.

Përktheu në gjuhën shqipe: Entela Shkreli

Botohet nga Organizata GO2 në kuadër të Planit të Lëvizjes së Qëndrueshme të Bashkisë Shkodër

www.go2albania.org

Autorësia dhe refuzimi

Çdo dublikim ose përdorim i objekteve të këtij raporti si fotografi, ilustrime, diagrama ose tekst nuk është i lejuar pa marrëveshje të shkruar.

Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij udhëzuesi lidhet me autorin(ët). Kjo nuk paraqet domosdoshmërisht opinionin e Komuniteteve Europiane. Komisioni European nuk është përgjegjës për çdo përdorim që mund t'i bëhet informacionit të përmbajtur në këtë udhëzues.

Publikime të tjera të PRESTO-s (të vlefshme në www.presto-cycling.eu)

PRESTO Udhëzues i Politikës së Pedalimit: **Promovimi i Pedalimit**

PRESTO Udhëzues i Politikës së Pedalimit: **Pedeleks**

25-fletë informimi të PRESTO-s mbi **Infrastrukturën e Bicikletës**, **Promovimin e Pedalimit** dhe **Legjislacionit mbi Pedeleksin**



Tabela e përmbajtjes

1	T'i jepet një Shtysë Pedalimit: PRESTO, udhëzuesi i politikës së pedalimit dhe fletët	1
2	Biçikleta në lëvizje	3
2.1	Nevoja për një infrastrukturë të integruar për biçikletën	3
2.1.1	Nevojat e pedaluesve	5
2.1.2	Punët e infrastrukturës së pedalimit	6
2.1.3	Kërkesat cilësore për infrastrukturën e pedalimit	8
2.1.4	Kërkesat e projektimit: Stabiliteti, zig-zaget dhe hapësira e lirë	10
2.2	Planifikimi i rrjeteve të pedalimit	11
2.2.1	Rrugët (jo pista ose korsi), struktura (jo projektimi)	12
2.2.2	Përzgjedhëse dhe progresive (jo një master-plan apo projekt)	12
2.2.3	Kërkesat kryesore të një rrjeti pedalimi	13
2.2.4	Zhvillimi i një rrjeti funksional të pedalimit	15
2.2.5	Integrimi i rrjeteve pedaluese funksionale dhe ato të shëtitjes	17
2.3	Projektimi i shërbimeve të pedalimit	20
2.3.1	Projektimi i shërbimeve sipas funksionit të rrugës	20
2.3.2	Shërbimet e zakonshme kushtuar pedalimit	23
2.3.3	Përzgjedhja e zgjidhjeve të projektimit	26
2.3.4	Shërbimet e biçikletës në kryqëzime	30
3	Vend-qëndrimi i biçikletës	33
3.1	Përse duhet një politikë e parkimit të biçikletës?	33
3.2	Parkimi afat-shkurtër dhe magazinimi afat-gjatë	34
3.3	Nivelet e kërkesës për parkim	36
3.4	Parkimi i biçikletës dhe zgjidhjet e magazinimit	39
4	Pedalimi dhe transpoti publik	42
4.1	Shërbimet e biçikletës në vend-shkëmbimet e transportit publik	42
4.2	Mbajtja e biçikletave në transportin publik	44
5	Fletët e informimit të PRESTO-s mbi infrastrukturën	47
6	Bibliography	49

Lista e figurave

Figura 1: Fletët e informimit PRESTO dhe udhëzimet e politikës.....	2
Figura 2: Ndarja e udhëtimeve me bëqikletë në distancë	5
Figura 3: Motivët e udhëtimit dhe ndarja e udhëtimeve me bëqikletë në Hollandë.....	6
Figura 4: Ndarja e bëqikletës për të gjithë udhëtimet e gjata në disa shtete europiane	7
Figura 5: Marrëdhënia e përdorimit të bëqikletës dhe cilësia e infrastrukturës së saj... ..	8
Figura 6: Seksioni i hapësirës së lirë	11
Figura 7: Shembull i një rrjeti hierarkik pedalimi	17
Figura 8: Tipet e rrugëve të rekreacionit.....	18
Figura 9: Rrugët e pedalimit turistik me distanca të gjata.....	19
Figura 10: Rrjeti i integruar i funksionit dhe rekreacionit	19
Figura 11: Tipet e kryqëzimeve dhe çështja e pedaluesve.....	31
Figura 12: Funksioni, zgjatja dhe tipi i parkimit të bëqikletës	35
Figura 13: Numri i vendparkimeve të zhvilluar për bëqikletën dhe rinovime të reja	37

1 T'i jepet një Shtysë Pedalimit: PRESTO, udhëzuesi i politikës së pedalimit dhe fletët

Politika e pedalimit është pjesë e axhendës së qyteteve europiane. Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, shumë autoritete lokale kanë ndërmarrë një sërë aktiviteteve për të nxitur bëqarësin si mënyrë e përditshme udhëtimi, sepse janë plotësisht të bindur se pedalimi është në të mirë të qyteteve (shikoni gjithashtu kapitullin pasardhës).

Por vendimarrësit dhe ata që përfshihen në zbatim përballen me shumë pikëpyetje. Si të zhvillojmë një politikë efektive pedalimi? Cila do të jetë qasja më e mirë në qytetin tim? Si të kemi një infrastrukturë të cilësisë së lartë? Si të nxisim përdorimin e bëqarësisë dhe ta kthejmë atë në kulturë? Suksesi në rritje i vazhdimësisë së Konferencës "Velocity" teston nevojën për dije rreth politikës së pedalimit dhe shkëmbimit të eksperiencave. Historitë e suksesshme janë bërë të njohura si praktika të mira frymëzuese. Udhëzimet e projektimit në kuadër kombëtar dhe lokal, kërkimi rreth pedalimit dhe qendrat e dokumentimit janë duke u shumëfishuar. BYPAD-i është bërë një mjet kyç për të përjasur dhe monitoruar politikën e pedalimit. Njohuritë janë zgjeruar, edhe pse shpesh janë të shpërndara. Kjo ka sjellë vështirësi në përshtatjen e tyre me realitete të ndryshme urbane.

Udhëzimet e PRESTO-s dhe fletët e informimit janë përpjekja e parë për të lidhur **njohuritë aktuale europiane dhe eksperiencën mbi politikën urbane të pedalimit**, në një format lehtësisht të qasshëm. Ato u zhvilluan jo vetëm për të mbështetur qytetet e PRESTO-s në aktivitetet e politikës së pedalimit, por që të shërbejnë edhe si **udhëzime referuese europiane**.

Projekti PRESTO: për promovimin e bëqarësisë për të gjithë, si një mënyrë e përditshme transporti:

Pesë qytete dhe një sërë ekspertësh u bashkuan në zhvillimin e strategjisë për të sjellë potencialin e pedalimit në qytete. Qytetet përfaqësojnë shkallë të ndryshme përmasash, vendndodhje kulturore dhe traditash mbi pedalimin. Të gjithë do të ndërmarrin veprime në tre fusha: infrastruktura e bëqarësisë, promovimin dhe bëqarësin elektrikë. Në vazhdim të projektit, ata do të përfitojnë nga seksionet trajnuese dhe këshillimet e ekspertëve. Trajnimet do të zhvillohen si një paketë klasash online rreth politikës së pedalimit, të cilat më vonë do të jenë të hapura për çdo të interesuar. www.presto-cycling.eu

Të 4 Udhëzuesit e Politikës së Pedalimit ofrojnë një kuadër të qartë dhe sistematik, për të ndihmuar vendimarrësit në zhvillimin e një **strategjie të politikës së pedalimit**.

Udhëzuesi mbi politikën paraqet një **kornizë të përgjithshme**, duke theksuar pikat themelore të një politike të integruar të pedalimit. Sigurisht nuk ka një masë që t'u përshtatet të gjitha përgjigjeve, prandaj udhëzuesi propozon krahasimin e qyteteve sipas niveleve të tyre të pedalimit si, **QYTETE FILLESTARE, QYTETE NË RITJE dhe QYTETE KAMPIONË** duke sugjeruar masa qasjeje, të cilat mendohet të jenë efektive për çdo fazë.

Tre udhëzues të politikës zhvillojnë hapësirën e politikës më vehte: **infrastruktura e bëqarësisë, promovimi i pedalimit dhe bëqarësin elektrikë**. Dy të parët paraqesin parimet e përgjithshme, çështjet kritike dhe faktorët vendimarrës, pa u futur në detajet teknike. I treti përqendrohet tek roli i bëqarësisë elektrike që mund të ketë në transportin urban dhe se si mund të promovohet nga autoritetet lokale dhe shitësit e bëqarëve.

Udhëzuesit e politikës shoqërohen me **25 fletë informimi mbi Zbatimin** të cilat japin shumë informacion mbi detajet dhe praktikën (teknike), zbatimin e masave të përzgjedhura të një

politike pedalimi. Ato janë menduar si instrumentë pune për të gjithë ata që përfshihen në **zbatimin e kësaj politike**.

Ky udhëzues është menduar të përdoret nga autoritetet lokale si përkufizues i strategjisë së politikës së pedalimit. Në të njëjtën kohë, duhet konsideruar si një punë progresive, që do të nxisë debate, reagime, rishikime dhe përsosmëri gjatë viteve në vazhdim.

UDHËZUESI PRESTO I POLITIKËS SË PEDALIMIT: KUADRI I PËRGJITHSHËM	
UDHËZUESI PRESTO I POLITIKËS PEDALUESE: INFRASTRUKTURA	UDHËZUESI PRESTO I POLITIKËS PEDALUESE: PROMOVIMI
FLETËT E INFORMIMIT MBI ZBATIMIN: INFRASTRUKTURA <i>Pjesët e rrjetit</i> • Qetësuesi i trafikut dhe pedalimi • Pistat e pedalimit • Korsitë e pedalimit • Rugët e pedalimit • Pedalimi kundër-rrjedhës • Bëqarë dhe autobusët • Pedalimi dhe lëvizja me këmbë <i>Kryqëzimet dhe kalimet rrugore</i> • Kryqëzimet me përparësi kalimi • Rrethrotullimet • Kryqëzimet me semaforë • Kryqëzimet me disnivele <i>Parkimi</i> • Parkimi i bëqarëve dhe zgjidhjet e ruajtjes • Parkimi i bëqarëve në qendër të qytetit • Parkimi i bëqarëve në zonat rezidenciale <i>Transporti publik</i> • Shërbimet e pedalimit në vende tranzite	FLETËT E INFORMIMIT MBI ZBATIMIN: PROMOVIMI <i>Rritja e ndërgjegjësimit</i> • Fushatat e gjera promovionale • Ngjarjet e bëqarëve dhe festivalet • Bëqarë / numëruesi i bëqarëve • Programet e pedalimit për shkollat • Fushatat e sigurisë së pedalimit <i>Informacioni</i> • Hartat e bëqarëve • Qendrat e informacionit / të lëvizjes <i>Trajnime dhe programe</i> • Trajnime dhe programe për të rriturve • Ngjarjet testuese të bëqarëve
	UDHËZIMI PRESTO I POLITIKËS SË PEDALIMIT: BËQARË ELEKTRIKE
	FLETËT E INFORMIMIT PËR ZBATIMIN: BËQARË ELEKTRIKE • Legjislacioni mbi bëqarët elektrike

Figura 1: Fletët e Informimit PRESTO dhe Udhëzuesi i Politikës

Ky është Udhëzuesi PRESTO i Politikës së Pedalimit mbi Infrastrukturën.

2 Bëqikleta në lëvizje

Nëse duam të zhvillojmë bëqikletën si një mënyrë e përditshme transporti, atëherë qytetet tona duhet t'i përshtaten asaj. QYTETET KAMPIONË TË PEDALIMIT e kanë mbi 30% mënyrën e lëvizjes me bëqikleta. Caktimi i këtij potenciali do funksionojë nëse pedalimi i një bëqiklete është fizikisht i mundshëm, i sigurt dhe tërheqës. Vetëm atëherë pedalimi do të jetë në gjendje të konkurojë automjetet në qytete.

- Për këtë, është e nevojshme një politikë e integruar e infrastrukturës së pedalimit.(2.1)
- Infrastruktura dhe projektimi i rrugëve duhet t'u përshtatet nevojave të pedaluesve. (2.2)
- Një rrjet pedalimi i mirë-organizuar duhet t'i lejojë pedaluesit të arrijnë lehtësisht, në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme çdo destinacion. (2.3)
- Në çdo situatë të veçantë, duhen bërë zgjedhje të kujdesshme të projektimit.(2.4)

Në pjesët në vazhdim do të merret në konsideratë politika e parkimit të bëqikletës (3) dhe lidhja intermodale ndërmjet bëqikletës dhe transportit publik (4).

2.1 Nevoja për një infrastrukturë të integruar për bëqikletën

Pse është e nevojshme infrastruktura e bëqikletës? Për shkak se një pjesë e madhe e qyteteve tona janë bërë të papërshtatshme për pedalim. Kjo vjen nga intensiteti dhe shpejtësia e trafikut të automjeteve dhe se rrugët për një kohë të gjatë janë projektuar për automjetet. Siguria për këmbësorët është arritur duke ndarë këta të fundit nga trafiku dhe duke organizuar kalimet, ndërsa pedaluesit janë harruar në këtë proces. Për të lehtësuar përdorimin e bëqikletës si një mënyrë e përditshme e transportit të qëndrueshëm do të jetë e nevojshme përshtatja e infrastrukturës.

Në planifikimin dhe projektimin e infrastrukturës së bëqikletës në qytete ne jemi përballur me dy nevoja shpesh herë kontradiktore.

- **Marrja parasyshe e pedaluesve**, si përdorues të veçantë të rrugës. Kjo nënkupton krijimin e hapësirës për pedaluesit dhe nevojat e tyre.
- **Infrastrukturë e integruar e pedalimit** në një hapësirë publike shpesh të kufizuar. Kjo do të thotë përshtatja e kërkesave konkurruese për hapësirën nga përdoruesit e ndryshëm, si dhe garantimin e cilësisë së projektimit urban.

Në lidhje me këtë, gjatë viteve janë zhvilluar dy filozofi planifikimi, të kundërta në dukje¹:

- **Qasja e rrjetit të ndarë**. Në këtë pikëpamje, infrastruktura e pedalimit do të konsiderohet si një rrjet shtesë me të drejtat e veta. Ky rrjet përbëhet nga infrastruktura e veçantë kushtuar bëqikletës, me normat e saj të projektimit teknik. Supozimi themelor është se bëqikleta dhe trafiku i rrugës janë të papajtueshme, kështu që rrjetet e ndara janë të nevojshme për siguri dhe për t'u shërbyer nevojave të të dy grupeve. Kjo është një qasje teknike dhe inxhinierike.
- **Qasje e përzier gjithëpërfshirëse**. Në këtë pikëpamje, rruga ekzistuese dhe rrjeti rrugor duhen korrigjuar për pedalues (dhe këmbësorë), përmes qetësimit të trafikut dhe bashkëpërdorimit të hapësirës me trafikun e automjeteve. Këtu supozohet që trafiku

¹ Përshtatur nga Arantxa Julien, 2000 - Comparaison des principaux manuels européens d'aménagements cyclables, CERTU

rrugor duhet të përshtatet me përdoruesit që kanë shpejtësi të ulët dhe të ngadalësojnë shpejtësinë e tyre, për të rritur sigurinë. Kjo përputhet me një shqetësim në rritje, për cilësi të lartë të hapësirës publike urbane e përdorur nga të gjithë.

Gjatë viteve përvoja e ka bërë të qartë se asnjë qasje nuk është zgjidhje e plotë dhe se përzierjet janë të nevojshme. Nga njëra anë, qasja e rrjetit të ndarë nuk është krejtësisht e realizueshme për të gjitha rrugët dhe rrjetet e pedalimit, për aq kohë sa është e kufizuar nga hapësira që është në dispozicion dhe buxhetet. Nga ana tjetër, përzierja nuk justifikohet qartë në intensitetet e trafikut të lartë apo shpejtësive.

Pra, çfarë është e nevojshme është që të kombinohen dy opsionet në një **qasje hierarkike të rrjetit**. Parimi i udhëzuesit duhet të jetë: nëse është e mundur përzierja dhe ndarja nëse është e nevojshme. Në gjithë këtë, **siguria është shqetësimi kryesor**.

- Përzierja, ose është ose mund të bëhet e sigurt. Përzierja e pedaluesve me trafikun e përgjithshëm është zgjedhje e paracaktuar. Lidhjet lokale dhe lidhjet e forta të ciklit të rrjetit të pedalimit duhet të vazhdojnë deri në zonat e trafikut të qetë pa ndonjë masë të veçantë fizike për pedaluesit, përveç shenjave të rastit apo sinjalistikës. Në shumë raste, ndikimi i trafikut të automjeteve mund të zvogëlohet nga mënyra të ndryshme për uljen dhe ngadalësimin e tij. Infrastruktura e tillë e padukshme ka të ngjarë të ketë një ndikim më të madh në nivelet e pedalimit se sa në masat e veçanta të tij. Justifikimi kryesor është që, duke zvogëluar volumin e trafikut të automjeteve dhe shpejtësinë e saj aktuale deri në max. 30 km / orë, do kemi një zgjidhje më të sigurt. Rrugët me shenjat e qetësimit të trafikut janë ende të arritshme për makinat, por duke përfshirë edhe pedaluesit dhe këmbësorët që mund të lëvizin të sigurt. Në këtë mënyrë, të gjitha rrugët lokale bëhen pjesë e rrjetit të pedalimit.
- **Rrjeti i ndarë, me qëllim sigurinë për arsye të trafikut dhe shpejtësive.** Një rrjet pedalimi nuk mund të mbulojë një qytet vetëm në rrugët e trafikut të qetë. Disa rrugë ose ura me rrjedhë të madhe trafiku, shpesh janë lidhje të shpejta dhe të drejtpërdrejta ndërmjet destinacioneve kryesore urbane. Këto, sikurse dhe rrugët kryesore kanë një potencial të lartë pedalimi dhe shpesh nuk pranohen alternativa. Shumë herë arteriet kryesore janë linja që lidhin zonat historike duke orientuar më lehtë të gjithë. Për shkak të intensitetit të lartë të trafikut dhe shpejtësive (50 km / orë ose më shumë), pistat e ndara të pedalimit do të jenë të nevojshme, sidomos kur pritet që të përdoren nga një numër i madh pedaluesish. Këto rrugë të cilësisë së lartë mund të bëhen 'pikat e zezë' të rrjetit të pedalimit, që ndërlidhin zonat lokale më të qeta. Në këto raste mund të ndërtohen tunelet dhe urat e pedalimit për të kaluar pengesa të tilla si; rrugët me trafik të ngarkuar, hekurudhat apo lumenjtë: këto mund të krijojnë lidhje të profilit të lartë të një rrjeti të ndarë, madje shpesh edhe rrugëdalje direkte nga trafiku. Rrugët kryesore të përdorura nga flukset e mëdha të pedaluesve mund të kenë trajtim të veçantë në semaforë apo të kenë përparësi mbi trafikun e automjeteve.

2.2 Infrastruktura e pedalimit: kërkesat themelore


Kur investojmë në infrastrukturën e bicikletës kemi nevojë të bëjmë zgjedhjet e duhura. A është vërtetë e nevojshme për të përmirësuar kushtet e pedalimit, për të bërë përdorimin e bicikletës të sigurt dhe tërheqëse për sa më shumë pedalues? Duke u nisur nga nevojat e pedaluesve mund të përkufizohen pesë kërkesa kyçe.

2.1.1 Nevojat e pedaluesve

Së pari ne duhet të jemi në dijeni për nevojat thelbësore të pedaluesve dhe karakteristikat e biçikletës.

Është e domosdoshme që të kihet parasysh se biçikleta përdoret kryesisht për **distanca të shkurtra**. Më shumë se 80% e të gjithë udhëtimeve me biçikleta janë më pak se 5 km të gjata. Tabela e mëposhtme tregon përqindjen e udhëtimeve me biçikleta për kategorinë e distancës në Rajonin e Flamandës të Belgjikës. Në vende ose rajone të tjera, mund të gjendet një ndarje e ngjashme e distancave të pedalimit. Biçikleta, në thelb është një mënyrë e transportit lokal.

Figura 2: Ndarja e udhëtimeve me biçikletë për distancë




Burimi: OVG Flanders 2001 (Mbikqyrja e sjelljes gjatë udhëtimit për në punë)

Duke parë qëllimin e udhëtimit, biçikleta është e përdorshme **për të gjitha llojet e udhëtimeve, nga të gjitha moshat**. Diagrama e mëposhtme tregon një sërë qëllimesh të pedalimit me normë të lartë në Hollandë. Në më shumë se 50% e udhëtimeve për në shkollë realizohen me biçikleta, por sigurisht ky lloj udhëtimi përfaqëson vetëm një pjesë të vogël, 9% e gjitha udhëtimeve. Për qëllimet e tjera të udhëtimit të tilla, si: pazari, në punë dhe shëtitje, biçikleta zë një pjesë prej 20-30%, që do të thotë se, në Hollandë 26% e udhëtimeve bëhen me biçikletë.

Në shumë politika të pedalimit vihet theks i fortë tek udhëtimi për në shkollë. Kjo ka kuptimin që fëmijët të bëhen pedalues me eksperiencë, si një mënyrë normale e udhëtimit të përditshëm dhe si hap i parë drejt qëndrimit në biçikletë. Megjithatë, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se udhëtimet për në shkollë përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të udhëtimeve. Nëse duam që të kemi një ndikim të rëndësishëm në drejtim të pedalimit duhet të nxisim një varg udhëtimesh, veçanërisht atë të lëvizjes në rrethina dhe për pazare.

Figura 3: Arsyet e udhëtimit dhe ndarja e udhëtimeve me biçikletë në Hollandë



Burimi: Studimi i Lëvizjes në Hollandë, 2007

Përveç udhëtimeve të përditshme, të domosdoshme biçikleta luan edhe një rol të rëndësishëm në udhëtimet për shëtitje. Në dhjetëvjeçarin e fundit pedalimi për shëtitje është rritur në mënyrë sistematike në të gjitha vendet europiane. Përveç cilësive të peisazhit rrethues, një rol kyç në nxitjen e udhëtimit me biçikletë për shëtitje, luan edhe shërbimi i biçikletës. Kur këto shërbime biçiklete drejtohen shumë nëpër zona urbane, ata janë njëkohësisht një potencial për mbështetjen e udhëtimeve ditore funksionale. Ndërsa nevojat funksionale dhe të shëtitjes së pedaluesve ndryshojnë, shërbimet duhet të integrohen ngusht në mjediset urbane, me qëllim nxitjen e përdorimit të dyfishtë.

2.1.2 Punët e infrastrukturës së pedalimit


Mes vendeve dhe qyteteve të ndryshme europiane, ka dallime të mëdha në përdorimin e biçikletës. Kjo tregon se vendet me cilësi të lartë të infrastrukturës së biçikletës kanë edhe përdorim të lartë duke bërë të pamohueshme lidhjen mes infrastrukturës së mirë dhe përdorimit të biçikletës.

Ne duhet të jemi të kujdesshëm, sepse ka mungesë statistikash të besueshme ndërkombëtare dhe europiane, për të krahasuar përdorimin e biçikletave në çdo vend. Shifrat e mëposhtme janë nga burime të ndryshme nëpërmjet kërkimit në internet. Edhe pse janë fragmentare dhe të llogaritura në mënyrë të ndryshme, ato japin një tregues të përafërt të përdorimit të ndryshëm të biçikletës në vendet dhe qytetet europiane. Përqindjet më të larta korrespondojnë me cilësitë më të larta të pedalimit.

Tabla 1: Përdorimi i biçikletës për të gjitha udhëtimet në disa vende dhe qytete Europiane

	Figurat kombëtare (1999 - 2008)	Përdorimi i biçikletës në nivel bashkie
Hollanda	26%	Bashkitë kryesore rezultojnë mes 35% dhe 40%; qytetet me përdorim më të ulët të biçikletës vlerësohen mes 15% dhe 20%
Danimarka	19%	Ndryshimet mes qyteteve më të mëdha janë relativisht të vogla: përgjithësisht në nivelin e 20% të gjithë udhëtimeve
Belgjika	10%	Një ndryshim i dukshëm mes Flanders (14%) dhe Ualonia (3%). Shumë qytete në Flanders përafërsisht 15%. Më i madhi: Bruzhi - thuhet 20%
Gjermania	10%	Shtetet federale perëndimore kanë një mesatare të lartë të përdorimit të biçikletës, veçanërisht Nordrajn-Uestfalen. Disa qytete variojnë mes 20% dhe 30%
Austria	9%	Kryeson: Graz (14%) dhe Salzburg (19%)
Zvicra	9%	Shumë qytete në një nivel më të lartë, si Berna (15%), Baseli (17%), Zyrihu (15%) dhe sidomos Uinterthur (afërsisht 20%)
Suedia	7%	Qytetet: 10%. Ekstremet: Lund dhe Malmö 20%. Qyteti më i vogël i Veshterås: 33%
Italia	5%	Një përjashtim i habitshëm, veçanërisht në luginën e Po-së, me vendet si Parma (mbi 15%) dhe Ferrara (rreth 30%). Një tjetër qytet parësor: Firenze (mbi 20%)
Franca	5%	Kryesor: Strasbourgu 12% dhe Avignon 10%
Irlanda	3%	Virtualisht asnjë ekstrem në rritje (Dublin 5% më së shumti)
Republika Çeke	3%	Pak qytete me disa gradë të përdorimit të biçikletës (Ostrava, Olomouc dhe Çeské Budejovice, ndërmjet 5% dhe 10%) dhe disa me përdorim diç më të lartë (Prostejov 20%)
Britania e Madhe	2%	Disa qytete të izoluar me një gradë përdorimi më të lartë të biçikletës (Jorku dhe Hul 11%, Oksford dhe sidomos Kambrixh thuhet 20%)

Figura 4: Përdorimi i biçikletës për të gjitha udhëtimet në disa vende Europiane




Burim: Komisioni Europian, kuotuar për Pedalimin në Hollandë, 2009.

Projekte kërkimore më specifike kanë treguar se infrastruktura e mirë e pedalimit, në të vërtetë çon në një përdorim më të madh të biçikletës. Projekti referues 'Fietsbalans' i realizuar nga Fietzersbond (shoqata Hollandeze e pedalimit), ka krijuar lidhje të qartë mes niveleve të

pedalimit në bashki dhe cilësisë së infrastrukturës së bëqikletës. Cilësia e infrastrukturës qe regjistruar objektivisht duke përdorur mjete matëse dhe është shprehur në të ashtëquajturën Rezultati Balancues i Bëqikletës. Në bashkitë hollandeze me një Rezultat të lartë Balanci, përdorimi i bëqikletës është mbi mesataren, 14% më e lartë se sa në bashkitë me Rezultat të ulët Balanci të bëqikletës.

Edhe një herë duhet theksuar se infrastruktura "pro" bëqikletës nuk është thjeshtë korsi dhe pista të veçanta pedalimi. Rezultati balancues i bëqikletës është pjesërisht bazuar në 'testimin e rrugëve': një rrugë mund të jetë pjesërisht një zonë 30 km/orë me masa të qetësimit të trafikut, por pa korsi apo pista pedalimi: kjo rrit rezultatin e cilësisë.

Figura 5: Raporti i përdorimit të bëqikletës dhe cilësia e infrastrukturës së pedalimit



Burimi: Fietsberaad (Holl)

2.1.3 Kërkesat cilësore për infrastrukturën e pedalimit

Çfarë i bën pedaluesit që të përdorin bëqikletat? Duke filluar nga nevojat e përdoruesve është e mundur të përcaktohen pesë kërkesat kryesore për infrastrukturën e pedalimit. Këto janë zhvilluar në Hollandë, por janë njohur kudo në botë si udhëzimet e vlefshme të politikës mbi pedalimin.

Nuk është gjithmonë ose kurdoherë e mundur të përmbushet çdo kërkesë, madje as në Qytetet KAMPIONE të Pedalimit, por kryesorja është që sa më shumë prej tyre të përmbushen, aq më shumë njerëz do të tërhiqen për të përdorur bëqikletat. Këto kërkesa duhet të mbahen parasysh gjithmonë si objektiva, me qëllim përmbushjen e tyre. Gjithashtu mund të përdoren si kriteret për vlerësimin e cilësisë dhe të metave të infrastrukturës ekzistuese.

- 1. SIGURIA.** Siguria është kërkesë themelore e pamohueshme dhe duhet të jetë shqetësimi kryesor. Pedaluesit nuk shkaktojnë asnjë rrezik të rëndësishëm, por ata vetë janë dhe ndihen të pambrojtur kur lëvizin në të njëjtën hapësirë me trafikun e automjeteve. Rreziku

rezulton nga dallimet e mëdha në masë dhe shpejtësi. Siguria mund të ofrohet në tri mënyra kryesore: (1) zvogëlimi i intensitetit të trafikut dhe ulja e shpejtësisë nën 30 km / orë e bën përzierjen e sigurt, (2) duke i ndarë pedaluesit në hapësirë dhe në kohë nga trafiku i ngarkuar dhe i shpejtë i mjeteve të motorizuara, zvogëlohet edhe numri i ndeshjeve të rrezikshme, (3) aty ku pikat e takimit mes trafikut të motorizuar dhe pedaluesve nuk mund të shmangen (në kryqëzime dhe kalime), ato duhet të paraqiten sa më qartë të jetë e mundur, në mënyrë që të gjithë përdoruesit të jenë të vetëdijshëm për rrezikun dhe të mund të përshtasin sjelljen e tyre.

- 2. DREJTIMI.** Drejtimi do të thotë se pedaluesi parapëlqen një rrugë sa më të drejtë që të jetë e mundur në destinacionin e tij. Mënyrat e tërthorta duhet të eliminohen sa më shumë dhe koha e përgjithshme e udhëtimit të minimizohet. Kjo e bën pedalimin shumë konkurrues për distancat e shkurtra, për aq kohë sa koha e udhëtimit është kryesisht më e ulët se sa kur udhëtohet me makinë. Të gjithë faktorët ndikojnë në kohën dhe drejtimin e udhëtimit: mënyra e tërthortë, numri i ndalesave në kalimet, rregullimi i dritave të trafikut, shpatet etj. Pastaj biçikleta mund të nxitet si një zgjedhje inteligjente dhe si një mjet i shpejtë transporti në një qendër të qytetit apo në shkollat lokale, punë apo shërbime të tjera.
- 3. KOHEZIONI** (ngjizje, bashkimi). Kohezioni lidhet me shkallën në të cilën pedaluesit mund të shkojnë pa ndërprerje nga origjina drejt destinacionit. Në thelb kjo do të thotë se pedaluesit do të vlerësojnë fort një rrjet të gjerë të një zone apo qyteti. Vendet e errëta dhe barrierat, ndalesat që shfaqen papritur janë mjaft dekurajuese për pedaluesit. Ndaj ata duhet të jenë të siguarur që kudo që ata shkojnë do gjejnë lehtësisht rrugën dhe me një cilësi të mirë. Çdo shtëpi, çdo kompani, çdo shërbim duhet të jetë e qasshme nga biçikleta dhe e lidhur nga një rrjet i përgjithshëm. Kohezioni gjithashtu nënkupton lidhjet e mira me rrjetet e tjera, kryesisht transportin publik dhe qendrat.
- 4. TËRHEQJA.** Tërheqja do të thotë se infrastruktura për biçikletë është e integruar mirë në një mjedis të këndshëm. Kjo është një çështje e perceptimit dhe imazhit, e cila mund të inkurajojë apo dekurajojë fuqishëm përdoruesit e biçikletës. M.q.s perceptimet janë shumë të ndryshueshme dhe personale, rregullat e përgjithshme janë të vështira për t'u dhënë. Por perceptimi duhet të marrë vëmendjen e plotë në planifikim, kur analizohet niveli i përdorimit dhe ankesa. Përveç dizajnit, cilësive të peizazhit dhe imazhit të një zone, kjo përfshin edhe faktorin e "sigurisë personale" aktuale dhe të perceptuar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në mbremje dhe gjatë natës.
- 5. KOMODITETI.** Komoditeti ka të bëjë me krijimin e një përvojë të kënaqshme, të qetë dhe relaksuese të pedalimit. Përpyekja fizike dhe mendore duhet të minimizohen sa më shumë të jetë e mundur. Për lëvizjet e qeta me biçikletë, përpyekjet e parregullta duhet të shmangen; ndalesat dhe nisjet e përsëritura janë të lodhshme dhe stresuese. Hartimi i keq i materialit ose mirëmbajtja shkaktojnë vibracione të bezdisshme, goditje dhe pengesa: kjo e bën pedalimin një detyrë më komplekse, që kërkon më shumë përqendrim dhe përpyekje për të kontrolluar ekuilibrin dhe probleme të tjera.

Në praktikë këto kërkesa nganjëherë mund të jenë në konflikt, pastaj çështja bëhet lidhur me arritjen e ekuilibrit më të drejtë. Konsideroni situatat e mëposhtme të përbashkëta.

- Rruga më e drejtpërdrejt shpesh shkon përgjatë një rruge të ngarkuar dhe për këtë arsye është më pak e sigurt apo tërheqëse seç duhet. Ndërtimi i korsive të ndara të biçikletës mund të garantojë sigurinë. Një rrugë alternative larg nga trafiku mund të jetë më e sigurt dhe tërheqëse, por ndoshta më e gjatë dhe më pak e drejtpërdrejtë.

- Për arsye sigurie, pedaluesve u kërkohet ndonjëherë që të bëjnë një kalim të tërthortë nëpërmjet një tuneli apo ure, ose të ndalojnë shpesh në semaforë. Të dy rastet zvoglojnë drejtimin (mënyrë e tërthortë, duke pritur kohën) dhe rehatinë (ngjitje shpatesh, duke ndaluar dhe duke filluar).
- Rruga më e drejtpërdrejt kalon nëpër parqe të gjelbërta ose jashtë zonës së ndërtuar. Kjo mund të jetë vizualisht tërheqëse, por shpesh është e pasigurt gjatë natës.

Nuk ka rregulla të vështira dhe të shpejta për zgjidhjen e të gjitha këtyre kontradiktave, por ka disa rregulla parësore:

- Siguria duhet të jetë gjithmonë përparësi kryesore.
- Rrugët e shërbimeve dhe rrugët e shetitjes duhet të kenë disa përparësi të ndryshme, siç tregohet në tabelën e mëposhtme. Rrugët e shpejta dhe të lehta janë vendimtare për udhëtimet ditore funksionale me biçikletë, edhe kur kalojnë nëpër një mjedis më pak tërheqës. Për rrugët e shetitjes, tërheqja është një shqetësim i madh dhe alternativat janë çështje shumë më të vogël.

Rrjeti funksional i pedalimit	Rrjeti i pedalimit për shetitje
Siguria	Siguria
Drejtimi	Tërheqja
Kohezioni	Kohezioni
Komoditeti	Komoditeti
Tërheqja	Drejtimi

2.1.4 Kërkesat e projektimit: Stabiliteti, zig-zaget dhe hapësira e lirë

Projektimi fizik i infrastrukturës së biçikletës ka nevojë të marrë parasysh hapësirën fizike të nevojave të pedaluesit. Kjo përfshin përmasat e pedaluesit dhe të biçikletës, por edhe karakteristikat fizike të veprimtarisë së lëvizjes me një biçikletë.

Stabiliteti. Biçikleta është mjet i paqëndrueshëm. Dëmtimet nga kamionat, gunga e vrimat në sipërfaqen rrugore dhe shpejtësia e ulët e pavullnetshme përcaktojnë stabilitetin dhe pengojnë hapësirën e nevojshme për manovra. Për të ruajtur ekuilibrin, një shpejtësi prej së paku 12 km / orë është e nevojshme. Për shpejtësi më të vogla se kjo, biçikleta fillon të tundet. Kjo ndodh kur tërhiqet larg nga një pozicion fillestar, ngadalëson në kthesa të ngushta dhe ngjitet në të përpjetë.

Zig-zaget. Gjatë lëvizjes, pedaluesit duhet të ruajnë vazhdimisht ekuilibrin e tyre. Kjo është arsyeja pse ata gjithmonë lëvizin pak nga njëra anë në tjetrën, edhe kur janë në lëvizje të shpejtë. Kjo quhet zig-zage. Përveç shpejtësisë, zig-zaget varen gjithashtu nga mosha, përvoja, kapacitetet fizike, ndërprerjet në sipërfaqen rrugore dhe kryqëzimet e drejtimeve. Në shpejtësitë normale të pedalimit, në kushtet normale, lëvizja zig-zage është rreth 0.20 m. Në situata ku pedaluesve u duhet të udhëtojnë në më pak se 12 km / orë, është e nevojshme më shumë hapësirë e lirë. Ky është rasti në semaforë, për shembull kur pedaluesve u duhet të tërhiqen larg nga pozicioni fillestar dhe kur ngjiten përpjetë. Në këtë lloj situatë, zig-zagia mund të kërkojë një gjerësi deri në 0.80 m.


Distancat e frikës nga pengesat. Gjithashtu projektuesve u duhet të marrin parasysh edhe frikën nga pengesat: pedaluesit do të duan të mbajnë distancë nga pengesat e ulëta, skajet e trotuareve dhe muret. Doracaku hollandez i Projektimit tregon distancën nga pengesat si mëposhtë: për pragjet me gjelbërim dhe gurët pengues të ulët, distanca është 0,25 m; për gurët pengues të lartë, 0.50 m dhe për muret e mbyllur, 0.625 m.

Seksioni i hapësirës së lirë. Tani ne mund të llogarisim gjerësinë e trotuarit të kërkuar për një pedalues: marrim gjerësinë e kërkuar nga biçikleta dhe përdoruesi i saj (0,75 m) dhe shtojmë manovrimet e zig-zageve, si dhe distancën nga frika e pengesave (këto kufinj mund të përputhen). Situata më e zakonshme është ajo e një pedaluesi që lëviz përgjatë një pengese nga njëra anë e tij: gjerësia minimale e hapësirës së nevojshme është 0.9 m.

Kur është e mundur ne mund të krijojmë hapësirë për lëvizje nga njëra anë në tjetrën. Kjo e bën pedalimin një aktivitet më të pëlqyeshëm social, lejon të rriturit që të pedalojnë pranë fëmijëve dhe lejon pedaluesit e shpejtë të parakalojnë ata më të ngadaltët. Kjo do të thotë që do të duhej një **gjerësi minimal prej 1.5 m**.

Për lëvizje të rehatshme në tunele do të duhej **minimalisht një hapësirë prej 0.75 m**.

Figura 6: Seksioni i hapësirës së lirë



Burimi: përshtatur nga CROW – 2006: Manuali i Projektimit për Trafikun e Bëqikletës. CROW-record 25

2.2 Planifikimi i rrjeteve të pedalimit

Duke pasur parasysh kërkesat e cilësisë së përgjithshme të infrastrukturës të biçikletës, hapi tjetër është aplikimi i tyre në zhvillimin e një rrjeti pedalimi. Ky kapitull ofron disa parime planifikimi për një rrjet pedalimi të dobishëm.

Zhvillimi i një rrjeti të tillë duhet të fillojë nga nevojat e udhëtimit të pedaluesve, të pavarura nga mënyrat e tjera të transportit. Një rrjet biçiklete i zhvilluar në mënyrë të saktë fillon nga ky parim dhe synon shërbimet e pedalimit në këto vende, ku flukset e larta të biçikletës janë të pranishme ose të pritshme.

2.2.1 Rrugët (jo pista ose korsi), struktura (jo projektimi)

Por çfarë është në të vërtetë një rrjet biçiklete? Këtu është një përkufizim i punës: **një rrjet pedalimi është një grup i ndërlidhur i rrugëve të sigurta dhe të drejtpërdrejta të biçikletave që mbulojnë një sipërfaqe të caktuar ose në nivel qyteti.**

Vlen të theksohet edhe një herë se një rrjet përbëhet nga **rrugët, jo pistat ose korsitë**. Cilësia e një rrugë të rrjetit nuk varet në një lloj të veçantë infrastrukture, të tilla si pistat e ndara.

Një rrugë biçiklete cilësore është një **itinerar i pandërprerë** që u afrohet mjaft kritereve të përshkuara më lart: i sigurt, i drejtpërdrejt, koheziv, i rehatshëm dhe tërheqës. Forma fizike që merr, mund të ndryshojë nga rruga në rrugë madje edhe brenda një rruge. Një itinerar mund të fillojë në një zonë banimi 30 km / orë përzihet me trafik jo të ngarkuar, lëviz mbi një korsi biçiklete ku trafiku është pak i ngarkuar, e drejtuar nëpërmjet një tuneli pedalimi nën unazë, vazhdon si një udhë e ndarë përgjatë një rruge kryesore, shkurtohet nëpër park dhe nëpër një zonë këmbësorësh arrin në stacionin hekurudhor.

Cilësia e rrjetit të tillë varet nga struktura që ka: sa mirë qëndrojnë ato me njëra-tjetrën, se sa lehtë e bën atë të arritshme në destinacionet urbane; sa mirë i shmang ose menaxhon situatat e rrezikshme. Kjo është një çështje që ndryshon nga cilësia e projektimit (më shumë rreth dizajnit do shyrtohet më poshtë).

2.2.2 Përzgjedhëse dhe progresive (jo një master-plan apo projekt)

Në një fazë vlen më shumë zhvillimi i një rrjeti biçiklete si një instrument planifikimi. Në thelb kjo nënkupton linja me ngjyra në një hartë, që lidhin destinacionet urbane. Si i tillë ai bëhet për projektuesit një udhëzues në terren: Në qoftë se projektuesi ka një pamje të qartë të funksionimit të një linjeje ose një kryqëzimi brenda rrjetit, ai do të jetë në gjendje të japë një zgjidhje të përshtatshme të projektimit. Nëse një lidhje është një rrjet biçiklete i nivelit të lartë që transporton pedalesit nga një zonë urbane në një tjetër, projektimi duhet të jetë i ndryshëm nga ai i një rruge lokale që lidh një lagje banimi me një rrugë kryesore apo një stacion treni.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se një QYTET FILLESTAR në zhvillimin e pedalimit duhet të fillojë nga zhvillimi i një master-plani të detajuar për një rrjet të plotë dhe pastaj të zbatojë atë në një hapësirë të shkurtër kohore. Me përmirësimin e kërkimit dhe analizës së modeleve të mundshme të udhëtimit, ky lloj parashikimi i nevojave të pedalesve që ende nuk ekzistojnë është në thelb abstrakt dhe i rrezikshëm. Përfshirja në një drejtim mund të kthehet në një gabim të kushtueshëm, duke arritur një pjesë të madhe të shërbimeve me përdorim të ulët.

Në fillim, rekomandohet që të bëhet një skicë e përafërt e pjesës më të madhe të lidhjeve të qytetit, thjeshtë që të kemi një pasqyrë. Por më pas, ka më shumë kuptim ndërtimi i një rrjeti të përzgjedhur në mënyrë progresive. Një zgjidhje do të ishte; të fillohet me qendrën e qytetit dhe me një zonë rezidenciale afër qendrës. Kthimi i rrjetit të tyre rrugor të përshtatshëm për biçikletat dhe të krijohet një rrugë kryesore me potencial të lartë që do të lidhi të dyja zonat. Rrethe të tjera mund të ndjekin të njëjtën mënyrë progresive duke lidhur shumë rrugë gradualisht. Një qasje e tillë ka disa avantazhe.

- Mund të fillohet me zonat me potencial më të lartë, ku njerëzit tashmë pedalojnë në një masë të konsiderueshme dhe ku trafiku është thuhetse i qetë etj. Kjo rrit shanset fillestare të suksesit.

- Përveç kësaj, përdorimi i rrjetit mund të monitorohet dhe të përmirësohet vazhdimisht. Numërimi i rrjedhjeve dhe i reagimeve nga pedalesit në lidhjet e humbura do të japë kontribut të vlefshëm. Nga monitorimi i kujdesshëm një rrjet mund të ndërtohet dhe të përshtatet lidhur ngushtë me nevojat e përdoruesve dhe mund të jetë shumë efektiv, si dhe me kosto të favorshme.

2.2.3 Kërkesat kryesore të një rrjeti pedalimi

Për një rrjet pedalimi, tre nga pesë kërkesat kryesore (shih më sipër) janë thelbësore: siguria, drejtimi dhe kohezioni. Dy të tjerat, komoditeti dhe tërheqja, janë më pak të rëndësishme në nivelin e rrjetit, por më shumë në nivelin e projektimit të veçantë të rrugëve dhe seksioneve rrugore (shih më poshtë).


Kërkesa më elementare e rrjetit është **kohezioni**. Pa kohezion nuk ka rrjet, por vetëm një grumbull rrugësh të vetme. Kjo çështje ka të bëjë me shkallën: sa më të ndërlidhura të jenë rrugët dhe që lejojnë pedalesit të zgjedhin lirisht itinerarin e tyre, aq më i fortë është rrjeti. Për pedalesit, kohezioni është një cilësi shumë e rëndësishme: kjo është hapësira përmes së cilës ata mund të arrijnë destinacionin e tyre.

Për të bërë një rrjet koheziv është i rëndësishëm një kuptim i qartë i origjinës kryesore dhe destinacioneve. Duke hequr linjat e dëshiruara midis tyre, ne mund të marrim një ide të rrjedhave të mundshme të udhëtimit. Duke përdorur modele kompjuterike, për të llogaritur modelet e udhëtimit është e mundshme që për QYTETET KAMPIONE me një numër mjaft të madh pedalesish, gjenerohen të dhëna kuptimplote.

Përveç lidhjeve kryesore, gjerësia e gojzës së rrjetës dhe dendësia janë faktorë të rëndësishëm që lidhen me kohezionin: sa më e vogël distanca mes rrugëve, aq më shumë pedalesit mund të bëjnë zgjedhje; për shembull mes një rruge të shpejtë por të ngarkuar apo e ngadaltë por të qetë, ose midis një rruge tatëpjetë e drejtpërdrejt dhe një më e gjatë që shmang kodrat e pjerrëta.

Përveç kohezionit të brendshëm të një rrjeti pedalimi, luan rol kyç kohezioni me rrjetet e tjera. Sidomos lidhja intermodale për rrjetin e pedalimit në pikat e transportit publik është shumë e rëndësishme, që udhëtimet me biçikletë të jenë një mënyrë transporti drejt dhe larg nga transporti publik.

Gjerësia e gojzës. Gojza është elementi i mbyllur, më i vogël i rrjetit. Gjerësia e saj është distanca mes rrugëve paralele. Sa më e madhe gjerësia e gojzës, aq më i vogël është densiteti i rrjetit (gjatësia e përgjithshme e lidhjes për njësi të sipërfaqes) dhe aq më i ulët niveli i kohezionit.



Gjerësia e gojzës është e rëndësishme vetëm në zonën e ndërtuar, ku ka një kërkesë për udhëtimet me biçikleta. Për rrjetet e pedalimit është e rekomandueshme një gjerësi prej 250 metrash.

Jashtë zonës së ndërtuar është e rëndësishme për arsye të lidhjeve që kanë të bëjnë me lëvizje ndërmjet fshatrave, qendrave dhe kënaqësive që tërheqin pedalesit.

Drejtimi i rrjetit ka të bëjë me distancën apo kohën që i duhet pedalesit, ndërmjet pikave të nisjes dhe të mbërritjes. Përsa i përket politikës, biçikleta duhet të ketë rrugë më të drejtpërdrejta sesa makinat në zonën e ndërtuar. Në këtë mënyrë, pedalimi është më i shpejtë se sa lëvizja me makinë.

Drejtimi në distancë mund të përcaktohet duke llogaritur faktorin e tërthortë. Sa më shumë, një rrugë nga A- B t'i afrohet në një vijë të drejtë, aq më mirë është për pedalesin.

Faktori i tërthortë. Faktori i tërthortë është lidhja mes distancës më të shkurtër përgjatë rrjetit dhe distancës absolute. Sa më i ulët faktori i tërthortë, aq më i lartë drejtimi i rrjetit. Faktori i tërthortë duhet të jetë patjetër i lidhur me distancën: i njëjti faktor i tërthortë përgjatë një distance të gjatë përfshin një faktor absolut më të gjatë. Për një rrjet të dendur pedalimi një faktor i tërthortë prej 1.4 paraqitet si një vlerë e mirë udhëzuese. Për ta bërë pedalimin sa më tërheqës për distanca të shkurtra (në zonat e ndërtuara) faktori i tërthortë i rrjetit të pedalimit duhet të jetë më i vogël se faktori i tërthortë për makinat.

Drejtimi në kohë ka të bëjë me ofrimin e lidhjeve që përmirësojnë rrjedhën e trafikut. Numri i kryqëzimeve për kilometër në të cilin një pedales nuk ka të drejtën e rrugës vlen si kriter. Për rrugët kryesore të pedalimit, ky numër duhet të jetë zero ose sa më afër zeros. Frekuenca e ndalesave për kilometër mund të shërbejë gjithashtu si një tregues për drejtimin në kohë. Një studim i rrjeteve të pedalimit në qytete të ndryshme holandeze (Fietsbalans, 2000) dha një frekuencë ndalesash prej 0.40 deri në 1,56 ndalesa për kilometër.

Kërkesa themelore e sigurisë është më shumë se një çështje e projektimit fizik. Shumë përpjekje mund të jetë bërë për të rritur **sigurinë në nivelin e rrjetit**. Më poshtë janë disa udhëzime:

- *Shmangni konfliktet me trafikun.* Sidomos në zonën e ndërtuar kjo nuk është e lehtë për t'u përmbushur, pa ulur cilësinë e fluksit të trafikut. Në teori lidhja e kryqëzimeve me disnivele të ndara (ura, tuneli) me rrugën e makinave do të ishte e përkryer në kuadër të sigurisë, por në praktikë semaforët dhe objektet për qetësimin e trafikut shpesh janë më të përshtatshme për të shmangur konfliktet e trafikut.
- *Tipet e ndryshëm të përdoruesve të rrugës.* Kur dallimet e shpejtësisë mes trafikut të motorrizuar dhe pedaluesve janë shumë të larta, atëherë përdoruesit e rrugëve duhet të ndahen nga njëri-tjetri për të pasur rrjetin "e tyre". Një rregull themelor është ndarja e pedaluesve nga trafiku i motorrizuar, gjithmonë kur shpejtësia është mbi 50 km / orë.
- *Ulja e shpejtësisë në pikat e konfliktit.* Kur nuk është e mundur ndarja e llojeve të automjeteve, dallimet mes shpejtësisë së trafikut të motorrizuar dhe pedaluesve duhet të minimizohen. Shpejtësia më e ulët e mjeteve të transportit (si biçikleta) përdoret si bazë. Shpejtësia maksimale e rekomanduar për përzierjen e trafikut është 50 km / orë, por 30 km / orë është shumë më e preferueshme, vetëm për minimizimin e aksidenteve të mundshme.
- *Sigurimi i kategorive të njohura rrugore.* Krijimi i situatave të njohura dhe të kuptueshme të trafikut është thelbësor për sigurinë. Zgjidhjet në përputhje me projektimin e rrugëve me funksione të ngjashme (në aspektin e hierarkisë rrugore) bëjnë situatat e mundshme të konflikteve, më të parashikueshme për pedaluesit dhe përdoruesit e tjerë, ndërkohë që nxit të tjerët për të parashikuar sjelljet.

2.2.4 Zhvillimi i një rrjeti funksional të pedalimit

Nëse do përqëndrohemi tek biçikleta si një mënyrë e përditshme e transportit, ne kemi nevojë të ngrejmë një rrjet shërbimesh, për ta bërë më tërheqëse. Qëllimi i rrjetit të shërbimeve funksionale të pedalimit është të lidhë destinacionet për udhëtime të tilla: si pazar, punë, edukim, socio-kulturore, vizita etj. Lidhjet duhet të jenë sa më të drejtpërdrejta që të jetë e mundur.

Zhvillimi i një rrjeti pedalimi të nevojshëm për një qytet apo një zonë të gjerë zakonisht përmbledhet në tre hapa kryesorë.

Hapi 1: përcaktimi i pjesës më të madhe të itinerareve; origjinat, zonat e destinacionit si dhe lidhjet mes tyre

Origjinat dhe destinacioni varen nga madhësia e zonës në studim. Në nivelin e rajonit urban, një qendër e qytetit mund të konsiderohet si një pikë e vetme e origjinës, ndërsa për rrjetin brenda qendrës, lagjet e ndryshme dhe rrethet mund të konsiderohen si pika të veçanta të origjinës.

Destinacionet kryesore tipike të pedalimit janë:

- lagjet rezidenciale dhe zonat përreth;
- shkollat dhe universitetet;
- zonat e pazareve;
- këndet sportive;

- përqëndrimi i zonave të punësimit të tilla si kompanitë e mëdha dhe të biznesit;
- shpërndarësit e mëdha të transportit publik, dhe pikat në disnivele të tyre (hekurudhat, autobuset, tramvajet, metrot)

Të gjitha këto destinacione mund të lidhen në një hartë me vija të thjeshta, të drejta. Rezultati, do të quhet rrjeti i preferuar (teorik) duhet të përmbajjë një grup të lidhjeve me potencial të lartë.

Hapi 2: detajimi i linjave të preferuara në rrugë

Lidhjet origjinë-destinacion duhet të detajohen në rrugët e preferuara. Kjo do të thotë se ato duhet të hidhen në një hartë, përgjatë rrugëve ekzistuese dhe infrastrukturës së pedalimit, mundësisht duke treguar lidhjet e humbura dhe shkurtesat e krijuara për pedalim. Fillimisht duhet të konsiderohet rruga më e shkurtër, e drejtpërdrejt dhe të kontrollohet kundër kritereve të tjera.

Përcaktimi i cilësive të duhura të projektimit të rrugëve do të varen nga rëndësia e lidhjeve, me fjalë të tjera numri i pedaluesve aktualë apo të pritshëm. Nëse numri i pedaluesve aktualë midis zonave është i konsiderueshëm, atëherë mund të shpërndahen në rrugët që do të krijohen. Të dhënat mbi sjelljen e udhëtimit ose numrit të flukseve të pedalimit në pika të ndryshme në një qytet, mund të ndihmojnë gjithashtu në përcaktimin e rrugëve kryesore të pedalimit. Vetëm në qytete ose në zona me shkallë të lartë të pedalimit, modeli i trafikut është një mundësi, për shembull për të përcaktuar mundësinë e ndërtimit të një ure për biçikleta si një rrugë më e shkurtër.

Hapi 3: krijimi i një hierarkie në rrjet


Një rrjet i gjerë pedalimi është më efektiv kur ka një hierarki të qartë. Ne të gjithë jemi të njohur me këtë formë të rrjetit rrugor, nga autostradat në rrugët rajonale deri tek rrugët e thjeshta lokale. Në mënyrë të ngjashme, përgjatë një rrjeti pedalimi të hapësirës urbane përdoruesit kanë përparësi të ndryshme në kohë të ndryshme: udhëtime të shkurtra ose udhëtime të gjata, qëllime shërbimi ose argëtimi, shpejtësia apo siguri. Në disa QYTETE NË RRITJE për të shtuar pedalimin dhe sigurisht në QYTETET KAMPIONE, disa rrugë do të përdoren shumë nga flukset e rëndësishme të pedaluesve, të cilët kanë nevojë për hapësirë të mjaftueshme dhe menaxhimin të rrjedhës së qetë të lëvizjes. Për t'iu përgjigjur këtyre nevojave të ndryshme, rrugët e pedalimit mund të klasifikohen në tri nivele (me shumë detaje mbi zbatimet e projektimit paraqiten më poshtë):

- RRUGËT KRYESORE kanë një funksion lidhës mes qyteteve apo nivel ndër-qytetas. Ata lidhin qendrat, fshatrat, qytetet e vogla dhe qytete të mëdha me njëri-tjetrin, jashtë zonës së ndërtuar.
- RRUGËT KRYESORE LOKALE kanë një funksion shpërndarës në nivelin e rrethit të zonës së ndërtuar. Ata ofrojnë lidhjet kryesore të pedalimit në mes rrethesh urbane dhe zonave të mëdha urbane.
- RRUGËT LOKALE kanë një funksion qasjeje në nivel lagje. Në thelb ato përfshijnë çdo rrugë ose udhë që mund të përdoret nga pedaluesit, duke lidhur të gjitha ndërtesat dhe origjinat e tjera, si dhe destinacionet e rrugëve të nivelit të lartë.

Në praktikën e tanishme autoritetet rrugore shpesh përdorin dy nivele të larta të lidhjeve të pedalimit. Niveli më i ulët (niveli lagje) shpesh nuk është i përfaqësuar në rrjetin e pedalimit. Kjo nuk vjen sepse nuk ka rëndësi, por për shkak se është shumë i detajuar dhe përkushtimi i infrastrukturës së biçikletës jo gjithmonë është i nevojshëm. Pedalimi do të jetë i mundur ose do të bëhet i mundur nga masat specifike të jo-pedaluesve (ose

"Infrastruktura e padukshme") të tilla si qetësuesit për uljen e nivelit të trafikut, zvogëlimi i shpejtësisë dhe devijimi i trafikut.

Figura 7: Shembull i një rrjeti hierarkik pedalimi



2.2.5 Integrimi i rrjeteve pedaluere funksionale dhe ato të shëtitjes

Fokusi i këtij udhëzuesi është pedalimi i përditshëm urban, me fjalë të tjera rrjetet e dobishme. Megjithatë, në dhe përreth zonave urbane ka rritje të kërkesës për përdorim të rrjeteve të shëtitjes. Për këtë, efekti tërheqës dhe përvoja e ofruar nga rrugët e biçikletës dhe rrethinat e saj është më e rëndësishme se lidhjet direkte.

Konceptet tradicionale janë rrugët me sinjalistikë në distanca të largëta si dhe rrugët me sinjalistikë me tematikë turistike, të cilat janë ende tërheqëse. Ata janë strukturuar si një numër i nyjeve të bashkuara me lidhje, duke u ofruar pedalesve lirinë e përcaktimit të udhëtimit të tyre në një rrjet. Eksplorimi me biçikletë i një rajoni është qëllimi i këtyre rrjeteve. Shumica e rrugëve të shëtitjes kalojnë përmes zonave urbane dhe qendrave të tyre.



Burimi i imazhit: T. Asperges

Figura 8: Tipet e rrugëve të shëtitjes

	Rrugët me distanca të gjata	Udhëtimet ciklike	Rrjeti i shëtitjes
Karakteristikat	Një rrjet kombëtar ose ndërkombëtar (p.sh. EuroVelo) me rrugë të ndërmjetme; lejon udhëtime ciklike të gjata	Rrethore, kryesisht rrugë lokale/rajonale duke përfaqësuar një temë specifike (p.sh. Rrugët e Arit të Zi në një zonë me miniera të Limburg). Shumë prej këtyre lagjeve u krijuan në dekadat e shkuara. Gjatësia mesatare 30-40 km.	Rrjeti rajonal i rrjetëzuar, përgjatë rrugëve tërheqëse për të eksploruar një rajon. Shumica me shtylla drejtuese përmes numrave të kryqëzimeve (dhe si pjesë shtesë përmes vendmbërritjeve)
Përdorimi	Përdorim fleksibël, për udhëtimet pedaluesit mund të planifikojnë vetëm një rrugë të mundshme (duke ndjekur shenjat)	Përdorim më pak fleksibël. E nevojshme për të mbaruar të gjithë rrugën për tu kthyer në pikënisjen tuaj. Gjithmonë rrugën e njëjtë. Pasi të jetë parë, kjo rrugë do të jetë më pak tërheqëse.	Përdorim shumë fleksibël, udhëtime lokale dhe rajonale. Mund të planifikohen nga pedalues individual dhe mund të ndryshohen gjatë udhëtimit (bazuar në një hartë me numrin e kryqëzimeve). E përshtatshme për udhëtime turistike.
Organizime të përgjegjshme	Shoqata (ndër) kombëtare pedalimi / turistike	Bashki, qarqe ose komuna apo nisma private nga shoqata lokale	Bashki, qarqe ose komuna. Bashëpunimi ndërmjet niveleve të ndryshme të politikës për të përfituar një rrjet uniform

Burimi: Udhëzuesi i Projektimit për infrastrukturën e pedalimit, CROW-record 25

Figura 9: Rugët turistike me distance të gjata të pedalimit



Rrugët me distanca të gjata në Gjermani




Rrjeti i pedalimit EuroVelo - ECF

Siç tregohet më lart rrjetet e shërbimeve të biçikletës dhe ato argëtuese u përgjigjen nevojave të ndryshme të përdoruesve: pedaluesit do të dëshironin të kalonin sa më shpejt të jetë e mundur nga A në B, ndërkohë pedaluesit që duan të shëtisin janë në kërkim të një udhëtimi sa më tërheqës, me synim eksplorimin e një rajoni.

Megjithatë, në praktikë, **rrjetet e shërbimeve (funktionale) dhe ato të shëtitjes priren të mbivendosen dhe duhet të integrohen**. Shumë pikë-nisje dhe destinacione për shëtitje janë në ose pranë një qendre (qyteti) ose një stacioni (hekurudhor). Në të njëjtën kohë ka edhe një kërkesë për udhëtime funksionale përgjatë rrugëve të qeta, alternative, tërheqëse dhe paralele me rrugët e ngarkuara, por me një distancë të konsiderueshme.

Në projektimin e rrjeteve të pedalimit, ka kuptim të merren parasysh dy përdorimet. Kjo bën të mundur kombinimin e përpjekjeve të dy autoriteteve që përfaqësojnë sektorin turistik dhe atë rrugor. Gjithashtu lejon një fond bazë për të realizuar në vazhdimësi shërbime me cilësi të lartë. Integrimi i shpërndarësve të mëdhenj të transportit është jetik, si për udhëtime të dobishme edhe argëtuese, për shkak të potencialit të kombinimit të transportit publik dhe të biçikletës në një zinxhir udhëtimi.

Figura 10: Rrjeti funksional i integruar dhe argëtues



Një shembull i rrjetit të pedalimit të integruar është *Suisse à Vélo*, rrjeti zviceran i biçikletës, ngjitje në mal, ushtrim patinazhi, vozitje me kanoe si dhe rrugët malore të biçikletave. I gjithë rrjeti është uniformisht i pajisur me sinjalistikë dhe ka gjithashtu lidhje me autobuzë, trena dhe varka në rrugë të ndryshme, për të shmangur rrugët e thepisura. Për më shumë informacion shiko www.schweizmobil.ch



Burimi i imazhit: Schweizmobil

2.3 Projektimi i shërbimeve të pedalimit

Planifikimi i një rrjeti është hapi fillestar, projektimi fizik i shërbimeve në terren është sfidë tjetër. Si të bëhet zgjedhja e drejtë e projektimit? Në këtë kapitull, së pari do të marrim në konsideratë rëndësinë e hierarkisë së rrugës dhe zgjidhjet e përbashkëta të projektimit që janë në dispozicion. Do të paraqitet një matricë për lidhjet, që nënvizon zgjidhjet dhe çështje specifike që kanë të bëjnë me udhëkryqet.

2.3.1 Projektimi i shërbimeve sipas funksionit të rrugës

Më sipër ne përcaktuam tre nivelet e rrugëve të pedalimit brenda një rrjeti pedalimi: rrugët kryesore, rrugët kryesore (të lartë) lokale dhe rrugët lokale. Përderisa rrugët e çdo niveli kanë funksione specifike, logjikisht kjo çon në kërkesat specifike të projektimit të tyre. Këto nuk janë rregulla të vështira e as të shpejta pasi gjithmonë duhet të merret parasysh konteksti lokal. Megjithatë, është e nevojshme që këto rregulla të mbahen parasysh si standardet e rekomanduara të cilësisë: këto karakteristika të projektimit do të lejojnë çdo rrugë, që të kryej plotësisht funksionin e saj të përcaktuar. Përveç kësaj, projektimi që përputhet me çdo nivel sqaron rrjetin për pedaluesit. Kjo i bën situatat dhe sjelljet më të parashikueshme për pedaluesit dhe përdoruesit e tjerë të rrugës, gjë që rrit sigurinë dhe rehatinë.

Rrugët kryesore

- Rrugë pedalimi të shpejtësisë së lartë dhe me distanca të gjata (duke tentuar drejt "autostradave")
- Kryesisht plotësuese në përdorim:
 - o Përdorim të nevojshëm - lidh qendrat, më shumë se 5 deri në 15 km;
 - o Përdorim argëtues - Rrugët me distancë të largët ndërmjet qendrave të qyteteve (10-50 km)
- Standarde të larta të cilësisë së projektimit:
 - o Ndarje maksimale midis këmbësorëve dhe trafikut të motorrizuar
 - o Rrugë të lira nga makinat
 - o Numri minimal i kalimeve:
 - Kalimet në rrugë me trafik të ngarkuar: të preferueshme janë shumëplanëshe - pa konflikte (tunel, urë)
 - Kalimet në rrugë të qeta: Përparësi për pedaluesit
 - o Materiale: asfalt ose beton
 - o Minimum i gjerësisë, 3 metra
 - o Drejtim i dyfishtë i rrjedhës së fluksit të biçikletave
 - o Shpat i kufizuar
- Jashtë zonave urbane këto rrugë janë shpesh përgjatë kanaleve, gjurmëve të vjetra hekurudhore ose paralel me hekurudhat ekzistuese
- Brenda zonave urbane rrugët kryesore janë "korridoret e biçikletave" me një përqendrim të lartë të fluksit të biçikletave për shkak të një dendësie të lartë të poleve tërheqëse (shkollat, zonat e dendura të jetesës, zonat e zyrave, ...)
- Rrugët kryesore janë të integruara me rrjetin e përgjithshëm të pedalimit dhe nuk përbëjnë një rrjet koherent më vehte



rrugë kryesore të pedalimit – burimi i imazhit: T. Asperges

Rrugët kryesore lokale

- Lidhja më logjike (e shpejtë) mes qendrave dhe lagjeve
- Kryesisht përgjatë rrugëve të ngarkuara
- Në shumicën e rasteve kanë nevojë për korsi të ndara të pedalimit për shkak të intensitetit dhe shpejtësisë së trafikut të motorrizuar
- Në qoftë se ka konflikte të mundshme mes kalimeve të lira dhe rrugëve me trafik të ngarkuar (semafor)
- Kur ndarja e konflikteve nuk është e mundur, një vëmendje shumë e madhe i kushtohet paraqitjes së konflikteve dhe zvoglimit të shpejtësisë (tabela shpejtësie, rrethrotullime ...)
- Rrugët kryesore lokale formojnë një rrjet koherent pedalimi në nivel rajonal apo urban



rrugët kryesore lokale të pedalimit – burimi i imazhit: T. Asperges

Rrugët lokale

- Rrugë që sigurojnë destinacione drejt lagjeve
- Detajim i rrjetit kryesor lokal të pedalimit (duke minimizuar gjerësinë e gojzës së rrjetës dhe faktorin e tërthortë)
- Kryesisht në zonat me qetësues të trafikut, ku ndarja e trafikut të makinave dhe pedaluesve nuk është gjithmonë e nevojshme ndërsa përzierja është e sigurt dhe e përshtatshme
- Theksi në krijimin e rrugëve të drejtpërdrejta në nivel lokal: shkurtesat, pedalimi në drejtim të kundërt, pedalim nëpërmjet zonave të këmbësorëve ...



rrugë lokale e pedalimit – burimi i imazhit: T. Asperges

2.3.2 Shërbimet e zakonshme kushtuar pedalimit

Para se të shkoni në detaje rreth vendimit se çfarë shërbimesh pedalimi janë të nevojshme dhe në cilat kushte, mëposhtë paraqiten shkurtimisht specifikat më të zakonshme të shërbimeve të pedalimit. Kjo nuk është aq e hapur sa ç'mund të duket, sidomos kur përkufizimet ligjore ndryshojnë midis vendeve. Këtu paraqesim një pasqyrë të shkurtër dhe fletët e informimit të Presto-s, ku mund të gjenden diskutime më të hollësishme.

Pistë pedalimi

Një pistë pedalimi është një strukturë dedikuar veçanërisht pedaluesve, e ndarë fizikisht nga trafiku i motorrizuar ose përmes një hendeku (largësie), ose duke u ngritur në një nivel më të lartë (lartësi)².

Ligjërisht, një pistë pedalimi është pjesa e rrugës publike rezervuar ekskluzivisht për biçikletat, e treguar me një shenjë në rrugë. Lëvizja apo parkimi i automjeteve në to nuk lejohen.

Pistat e pedalimit janë përgjatë rrugëve lidhëse me trafik të ngarkuar, ku intensiteti dhe shpejtësia (mbi 50 km / orë) e trafikut të motorrizuar është shumë i lartë për përzierje me pedaluesit, në mënyrë të sigurtë. Në këto raste, pistat e pedalimit janë zgjidhja më e sigurt (më të sigurt se korsitë e pedalimit), për shkak të ndarjes fizike.

Një disavantazh i pistave të pedalimit është se pedaluesit janë jashtë fushës së drejtpërdrejt të shikimit të automjeteve. Kjo përbën një problem kur makina dhe biçikleta ndeshen me njëri-tjetrin në udhëkryqe. Në këto pika është e rëndësishme të vendoset kontakti me sy (prezantimi i konfliktit) dhe në shumicën e rasteve është e këshillueshme që të bëhet rruga e pedalimit paralel rrugës së automjeteve, përpara kryqëzimit.

→ më shumë mund të gjeni në fletën e informimit mbi PISTAT E PEDALIMIT

² Në përdorimin Britanik quhen korsitë jashtë-karrexhatës



Pistat e pedalimit – burimi i imazhit: T. Asperges

Korsia e pedalimit

Një korsi pedalimi është një hapësirë e rezervuar për pedaluesit në rrugë, e treguar nga shenjat e rrugës dhe logot e biçikletës dhe ndoshta me ngjyra.

Ligjërisht, një korsi biçiklete është një pjesë e rrugës publike rezervuar ekskluzivisht për pedaluesit. Lëvizja ose parkimi i automjeteve në to, zakonisht nuk lejohet.

Korsitë e biçikletës janë përdorur përgjatë rrugëve lidhëse ku intensiteti i trafikut të motorizuar është mjaft i ulët, por shpejtësia e lartë ende nuk lejon përzierjen e pedaluesve dhe makinave. Korsitë e pedalimit gjithashtu, janë përdorur edhe përgjatë rrugëve urbane të ngarkuara, ku ka mungesë të hapësirës për të ndërtuar pista pedalimi, edhe pse janë më pak të sigurta. Në këto raste shpejtësia e trafikut të motorizuar duhet të reduktohet në max. 50 km / orë. Kujdes duhet t'i kushtohet gjerësisë së mjaftueshme dhe distancave të sigurisë nga trafiku dhe makinat e parkuara.

Korsitë e biçikletave janë gjithmonë të shënuara me një vijë të dyfishtë në rrugë, të ndërprerë apo të vazhdueshme sipas rregullave kombëtare. Për të bërë korsinë e pedalimit më të qëndrueshme, shpesh sipërfaqja e tyre është lyer me ngjyrë të tilla si: të kuqe (Hollandë), blu (Danimarkë) ose gjelbërt (Francë).

→ më shumë mund të gjeni në fletën e informimit mbi KORSITË E PEDALIMIT



Korsitë e pedalimit – burimi i imazhit: T. Asperges

Korsi biçiklete e këshillueshme

Një korsi e këshillueshme është një hapësirë e sugjeruar për pedaluesit në rrugë, e krijuar me shenja rrugore, sipërfaqe të tilla si simbole të biçikletave, shigjeta dhe SHIRITA (në disa vende të quajtura gjithashtu korsi sugjerimi). Ligjërisht kjo është pjesë e karrexhatës që do të thotë se trafiku i motorrizuar është i detyruar të kalojë në të dhe është i lejuar të parkojë.

Në fakt, kjo është një formë e përzier mes trafikut të motorrizuar me biçikletat. Korsa e këshillueshme thjesht shërben si shenjë e kapshme nga syri, për të tërhequr vëmendjen e shoferëve të makinave rreth pranisë së mundshme të pedaluesve dhe pikave të mundshme të konfliktit. Ajo gjithashtu shërben për të ngushtuar vizualisht karrexhatën. Në këtë mënyrë, këto detaje kanë për qëllim të ndikojnë në sjelljen e shoferëve dhe të shkaktojnë më shumë respekt për pedaluesit.

Korsitë e sugjeruara të pedalimit janë përdorur në rrugët (urbane) ku intensiteti i trafikut të motorrizuar është shumë i lartë për të përzier krejtësisht përdoruesit e rrugës. Një korsi e tillë mund të jetë alternativë në rrugët e ngushta, ku mungon hapësira për një korsi normale pedalimi.

→ më shumë mund të gjeni në fletën e informimit mbi **KORSITË E PEDALIMIT**



Korsitë e këshillueshme të pedalimit – burimi i imazhit: T. Asperges

Rrugët e biçikletave

Një rrugë biçiklete është e projektuar në mënyrë që pedaluesit të dominojnë fizikisht dhe vizualisht, duke shprehur vizualisht se në këtë mënyrë trafiku i motorrizuar tolerohet si një mysafir. Në praktikë, përgjithësisht duken si pista të gjera të biçikletës mbi të cilat makinat janë të lejuara.

Në fakt, rrugët e biçikletës janë një formë e trafikut të përzier, pa një status të veçantë ligjor. Ligjërisht, makinat janë të lejuara, si në një rrugë të zakonshme, por projektimi mbështet fuqishëm pedaluesit. Vetëm në Gjermani rrugët e biçikletës kanë një status ligjor në kodin e trafikut, si një rrugë e dedikuar për pedaluesit në të cilat makinat janë të lejuara.

Rrugët e biçikletës janë përdorur në zonat urbane, në rrugët me intensitet të lartë biçikletash dhe ku trafiku i motorrizuar ende ka nevojë për qasje. Këto rrugë duhet të kenë një kufizim të shpejtësisë me rreth 30 km / orë dhe të përdoren në zonat e banimit vetëm me trafikun lokal. Për të përmirësuar shpejtësinë dhe rehatinë, këto rrugë duhet të kenë të drejtën e lëvizjes në kryqëzime.

→ më shumë mund të gjeni në fletën e informimit mbi **RRUGËT E PEDALIMIT**



rrugët e pedalimit– burimi i imazhit: Fietsberaad / Sinjalistika gjermane e rrugëve të pedalimit

2.3.3 Përzgjedhja e zgjidhjeve të projektimit

Si të vendosim për zgjidhjen më të mirë në një vend të caktuar? Shpesh, do të ketë pikëpamje të ndryshme dhe në të vërtetë nuk ka zgjidhje të vetme, ideale. Megjithatë, vendimi duhet të jetë i bazuar thellësisht në një numër kriteresh të qarta dhe parime udhëzuese.

Vendimi varet nga faktorët kyç të mëposhtëm.

- Funksioni i rrugës, nga rrugët kryesore të pedalimit në rrugë lokale
- Mjedisi hapësinor, kryesisht brenda ose jashtë zonës së ndërtuar
- Situata e përgjithshme e trafikut, sidomos intensiteti dhe shpejtësia e trafikut të motorrizuar, të lidhur me funksionin e rrugës (rrugë lidhëse, rrugë shpërndarëse, rrugë hyrëse) dhe karakteristikat fizike (gjerësia në dispozicion, numri i korsive etj.).

Parimet bazë

Parimet udhëzuese në vijim, përgjithësisht të njohura si themelore, duhet të përdoren si një rregull bazë.³

JASHTË ZONËS SË NDËRTUAR	BRENDË ZONËS SË NDËRTUAR
GJITHMONË ndarje e rreptë e pedaluesve dhe trafikut të motorrizuar.	Përzierja si mundësi e paracaktuar Ndarja kur është e nevojshme prej shpejtësisë së lartë (> 50 km/orë) dhe intensiteti i lartë i trafikut të motorrizuar
SHMANGIE KONFLIKTI	PRANI KONFLIKTI

³ Kjo bazohet në eksperiencën e gjerë dhe punën kërkimore Hollandeze, përmes analizave të statistikave të aksidenteve. Shikoni CROW Record 85 - Design Manual for bicycle traffic.

Jashtë zonës së ndërtuar

Për shkak të dallimeve të shpejtësisë mes pedaluesve dhe trafikut të motorizuar, rreziku i konflikteve dhe plagosjeve është shumë i lart për të lejuar të dy palët që të ndajnë të njëjtën hapësirë. Atëherë pikënisja është **shmangia e konfliktit nëpërmjet ndarjes**. Ndarja e shërbimeve të pedalimit është gjithmonë e nevojshme për të rritur sigurinë. Tipi i veçantë i shërbimeve të pedalimit është i lidhur ngushtë me funksionin e rrugës në hierarki dhe kufizimet e shpejtësisë.

Manuali doracak i projektimit për trafikun e biçikletave në Hollandë rekomandon që të përdoren shërbimet e ndara (pista pedalimi) për shpejtësi mbi 80 km / orë. Deri në 60 km / orë, intensiteti i trafikut rrugor në një lidhje lokale të pedalimit mund të bëjë korsitë ose përzierjen si një mundësi e pranueshme.

Matrica e mëposhtme ofron udhëzime më të hollësishme⁴ për një vendim.

				Funksioni i rrugës së pedalimit	
		Shpejtësia (km/orë)	Intensiteti (makina/ditë)	Rrjet bazik	Rruga kryesore e pedalimit ($I_{bic} > 2000$ biçikl./ditë)
		n/a	0	Pistë e vetmuar	
Funksioni i rrugës	Rruge shpërndarëse	60	1-2.500	Trafik i përzier ose korsi e sugjeruar pedalimi	Rrugë pedalimi, nëse $I_{automj} < 500$ makina/ditë
			2.000 – 3.500	Korsi e këshillueshme pedalimi ose korsi pedalimi	Pistë pedalimi
			> 3.000	Pistë pedalimi	
	Rruge përmbledhëse	80	parëndësishme	Pistë e ndarë pedalimi	

⁴ Përshtatur nga CROW Record 85 – Design Manual for Bicycle Traffic. Vlerat kufitare të shpejtësisë variojnë nga njëri vend në tjetrin.

Brenda zonës së ndërtuar

Brenda zonës së ndërtuar dhe komplekse është thuajse e pamundur ndarja e përdoruesve të veçantë dhe shmangia e situatave të konfliktit. Prandaj pika e nisjes në zonën e ndërtuar përbën **paraqitjen e konflikteve**. Projektimi i rrugës dhe shërbimeve të pedalimit duhet të jetë në një mënyrë të tillë që të gjithë përdoruesit e rrugës të jenë vizualisht të ndërgjegjshëm në situata të mundshme të konfliktit mes llojeve të ndryshme të përdoruesve. Në praktikë kjo pikënisje do të thotë se shërbimet e bëqarëve janë të përziera ku është e mundur dhe të ndara kur është e nevojshme.

Shumica e lidhjeve në rrjetin bazë të bëqarëve duhet të kalojnë përmes rrugëve të qeta me një limit shpejtësie 30 km / orë. Kjo është situata më e sigurt dhe nuk kërkon infrastrukturë specifike për bëqarët. Përzierja duhet të jetë mundësi e paracaktuar. Në rrugët e ngarkuara dhe kryqëzimet komplekse, sidomos në shpejtësitë e larta preferohet edhe ndarja e intensitetit.

Matrica e mëposhtme ofron udhëzime më të hollësishme⁵ për një vendim.

					Funksioni i rrugës së pedalimit				
					Shpejtësia (km/orë)	Intensiteti (makina/ditë)	Rrjeti bazik		Rruga kryesore e pedalimit
							(I_{bic} < 750/ditë)	(I_{bic} 500-2500/ditë)	(I_{bic} > 2000/ditë)
					Jo-aplikueshme	0	Pistë e vetmuar		
Funksioni i rrugës së trafikut	Rrugë me qasje lokale	Hapësirë pedonale ose 30 km/orë		1 – 2.500	Trafik i përzier (me ose pa korsi të këshillueshme pedalimi)	Rrugë pedalimi ose pistë pedalimi (me të drejtë kalimi)			
				2.000 - 5.000					
				> 4.000					
	Rrugë shpërndarëse	50 km/orë	2x1 korsi	Jo-aplikueshme	Pistë ose korsi pedalimi				
			2x2 korsi						
		70 km/orë					Pistë pedalimi (pranë ose e veçuar)		

⁵ Përshtatur nga CROW Record 85 – Design Manual for Bicycle Traffic. Vlerat kufitare të shpejtësisë variojnë nga njëri vend në tjetrin.

Më shumë mënyra për t'u dhënë përparësi pedaluesve

Brenda zonave të ndërtuara, rrjeti i pedalimit duhet të jetë aq i dendur sa të jetë i mundur, me rrugë të drejtpërdrejta mes pikënisjeve dhe destinacioneve. Të shkuarit drejt një gjerësie maksimale të rrjetës prej 200 deri 250 m, bën të mundur që biçikleta të jetë konkurruese e fortë në distancat e shkurtra. M.q.s hapësira në zonat e banuara është e pakët, kombinimi i trafikut të biçikletës me mënyrat e tjera të trafikut shpesh mbetet e vetmja mundësi. Tre zgjidhje për përfitime të pedaluesve janë bërë të përdorura gjerësisht vitet e fundit dhe duhet të përfshihen edhe në kode të shumta të trafikut. Ato mund të zëvendësohen shpejtë, lehtë dhe me kosto të ulët. Efekti i tyre do të shumëzohet kur të jenë përgjithësuar, edhe pse kushtet e sigurisë duhet të respektohen.

Pedalimi në drejtim të kundërt në rrugët me një korsi.

Lejimi i pedaluesve që të përdorin rrugët me një korsi, në të dyja drejtimet është një mënyrë shumë e fuqishme për të rritur drejtimet në rrugët e pedalimit. Rrugët me një korsi krijojnë alternativa të rëndësishme për pedaluesit dhe një rrugë kundër-rrjedhë është në fakt një shkurtime. Kjo masë është gjerësisht e përdorshme dhe në disa raste e zbatuar në mënyrë sistematike. Në Belgjikë është bërë ligjërisht një zgjidhje e përcaktuar, me përjashtim kur profili i rrugës është shumë i ngushtë.

→ më shumë mund të gjeni në fletën e informimit mbi **PEDALIMIN KUNDRA-RRJEDHËS**

Korsitë e autobusit/biçikletës.

Nën shpejtësinë 30 km / orë, pedaluesit dhe autobusët mund të përzihen sëbashku. Në shpejtësi më të larta, ata duhet të ndahen: dallimet sipas shpejtësisë dhe distancës së frenimit e bëjnë përzierjen të pasigurt. Mundësia ideale, do ishte që rrugët e biçikletës të krijohen larg rrugëve të autobusëve. Megjithatë, në qytetet me rrjete të dendura të autobusëve, kjo nuk është gjithmonë e mundur. Për më tepër, autobusët shpesh janë të mbërthyer në trafik dhe për të rritur rrjedhjen dhe zvogëluar kohën e udhëtimit të tyre, janë kushtuar korsi të veçanta. Në vitet e fundit janë duke u përhapur korsitë e autobusit / biçikletës. Këto korsi janë tërheqëse për biçikletat, pasi krijojnë gjithashtu shkurtime për pedaluesit dhe lejojnë që të kalojnë radhët e makinave. Megjithatë, siguria duhet të jetë e garantuar. Autobusët duhet të lëvizin në më pak se 30 km / orë dhe korsa duhet të jetë e gjerë mjaftueshëm për autobusët, por që të kalojnë edhe biçikletat. Në rrugët më të gjata, autobusët thjesht do të lëvizin shumë më shpejt për sigurinë dhe rehatinë e pedaluesve. Korsitë e autobusit / biçikletës nuk duhet të përdoren si një mënyrë për të shmangur zgjidhje të vështira: një korsi apo pistë pedalimi është gjithmonë më e sigurt dhe më e rehatshme dhe shpesh mund të sigurohet duke marrë nga një korsi e trafikut ose një korsi e parkimit.

→ më shumë mund të gjeni në fletën e informimit mbi **BIÇIKLETA DHE AUTOBUZËT**

Vijë-ndalesat e avancuara për pedaluesit.

Në udhëkryqet me semaforë, një vijë-ndalesë e avancuar për pedaluesit krijon një hapësirë drejtëkëndore për ta, që të presin në frontin e makinave gjatë fazës së dritës së kuqe. Në këtë mënyrë, pedaluesit janë shumë të dukshëm dhe mund të kthehen majtas në mënyrë të sigurtë në kohën e ndezjes së dritës së gjelbërt. Përveç kësaj, një rrjedhje e korsisë së biçikletës drejt vijë-ndalesës së avancuar, i lejon ata të kapërcejnë rradhën. Kjo masë është e dobishme, kur dallimi mes shpejtësisë së makinave dhe pedaluesve nuk është shumë i lart (<50 km / orë). Në udhëkryqet komplekse dhe të ngarkuara është më e sigurt ndarja e pedaluesve nga trafiku rrugor dhe kthesa e majtë në dy hapa.

→ më shumë mund të gjeni në fletën e informimit mbi **KRYQËZIMET ME SEMAFORË**



Korsia e këshillueshme, korsia autobus/bëqarëve, vijë-ndalesa e avancuar – burimi i imazhit: T. Asperges, D. Dufour

2.3.4 Shërbimet e bëqarëve në kryqëzime

Mbi 70% e të gjitha aksidenteve që rezultojnë fatale ose të rënda, ndodhin në udhëkryqe. Shumë prej tyre janë shkaktuar gjatë kthimeve të automjeteve dhe goditjet ndaj bëqarëve që lëvizin drejt. Në të njëjtën kohë, kryqëzimet kanë një ndikim të fortë në rehatinë dhe në drejtimin e rrugëve të bëqarëve. Kjo është arsyeja pse kryqëzimet dhe kalimet në rrjetin e bëqarëve duhet të projektohen me kujdes të veçantë: pedaluesit duhet të jenë në gjendje t'i kalojnë ato ose të kthehen majtas-djathtas në mënyrë të sigurt, shpejt dhe qetë.

Edhe njëherë, zgjedhja e projektimit do të varet nga funksioni i rrugës së bëqarëve, përmbajtja hapësinore (brenda, jashtë zonës së ndërtuar), shpejtësia dhe intensiteti i trafikut të motorizuar.

Siguria këtu është kusht thelbësor i pedalimit. Një rregull i përgjithshëm i projektimit për kryqëzimet është **paraqitja e qartë e konflikteve** përmes **projektimit të thjeshtë**.

- Dukshmëria është vendimtare: pedaluesit duhet të jenë sa më shumë në fushën vizive automobilistike. Një rekomandim i rëndësishëm për pistat fizikisht të ndara të bëqarëve është që **të kthehet në rrugën e lëvizjes** (më afër me karrexhatën) përpara se të arrijë kryqëzimin.
- Edhe për arsye sigurie, **minimizimi i diferencës së shpejtësisë**: shpejtësia duhet të ulet sa më afër shpejtësisë së lëvizjes së bëqarëve rreth 20-30km / orë.
- Përveç kësaj **masa specifike të pedalimit** mund të aplikohen, të tilla si ishujt e trafikut, nëpër rrugët e veprimeve, vijë-ndalesat e avancuara dhe bypass-et e bëqarëve.

Drejtimi është një tjetër çështje kyçe e pedalimit në udhëkryqe. Vonesa e shkaktuar nga pritjet në udhëkryqe, rrit kohën e udhëtimit me bëqarë. Projektimi dhe rregulloret duhet të synojnë që të **minimizojnë kohën e pritjes**. Masat që duhen marrë në konsideratë janë: përparësia e pedaluesve në rrugë, ishuj qendrorë të trafikut, zbulimin e pedaluesve në semaforë, ciklet e shkurtra apo valët e gjelbërta në semafor, bypass-et e kthimit djathtas dhe në përgjithësi, rrugët e përgjithshme logjike dhe të drejtpërdrejta në të gjithë kryqëzimin (shmangia e kalimit në hapa).

Së fundi, **rehatia** është gjithashtu në vëmendje. Kjo është kryesisht çështje e respektimit të **rrezes së kthesës**, duke lejuar që pedaluesit të kthehen lehtësisht, pa pasur nevojë të ngadalësojnë apo të jenë të detyruar të largohen nga rruga e tyre.

Tabela ofron një pasqyrë të tre zgjidhjeve themelore të projektimit. Disa parime kryesore për të mbajtur në mendje janë:

- Një **kryqëzim i thjeshtë me të drejtë të lëvizjes në të djathtë** është zgjidhja themelore mbi rrugët me 30 km / orë me trafik të përzier.

- Një **rrethrotullim me një korsi të vetme** është zgjidhja më e sigurt kur trafiku është i ngarkuar, sepse pedaluesit janë futur mes makinave me shpejtësi të ngadalësuar. Rrethrotullimet me shumë korsi janë shumë më të rrezikshme dhe duhet të jenë të projektuara me një pistë pedalimi të veçantë, rreth tij.
- Të gjithë **kryqëzimet me semaforë** janë të rrezikshëm dhe në thelb nënkuptojnë kohën e pritjes. Megjithatë, ata janë të domosdoshëm në rrugët kryesore me rrjedhje të madhe trafiku. Projektimi duhet të bëjë të dukshëm pedaluesit, të lejojë manovrimet të shkurtra dhe të lehta, si dhe të zvogëlojë kohën e pritjes.
- Në zgjidhjet me **disnivele të ndara**, të tilla si tunelet apo urat duhet të përdoren për të anashkaluar rrugët më të ngarkuara si dhe kryqëzimet komplekse dhe të rrezikshme.

→ më shumë mund të gjeni në fletën e informimit mbi KRYQËZIMET ME TË DREJTË TË LËVIZJES

→ më shumë mund të gjeni në fletën e informimit mbi KRYQËZIME ME RRETHROTULLIME

→ më shumë mund të gjeni në fletën e informimit mbi KRYQËZIME ME SEMAFORË

→ më shumë mund të gjeni në fletën e informimit mbi KRYQËZIME ME DISNIVELE

Figura 11: Tipet e kryqëzimeve dhe çështja e pedaluesve

Projektimi i rekomanduar i kryqëzimit	Qëllimi/ fusha e aplikimit	Kushtet e dizenjimit për pedalimin	Çështjet kyçe të dizajnit për pedalues
KRYQËZIMI ME PËRPARËSI KALIMI	Rrugë të qeta, më pak se 30 km/orë ose rrugë me thuajse 50 km/orë Të gjitha rrugët e pedalimit Brenda zonës së ndërtuar	Intensitetet e rrugës dhe kapërcueshmëria e pedaluesve Rrugë ekuivalente ose rrugë me nivele të ndryshme përparësie (sinjalistikë vertikale dhe horizontale korresponduese)	Rruga e pedalimit ka përparësi, dhe përparësi kalimi ose është ekuivalente (përparësi-nga-rregulli i paracaktuar) Përkulje ose kërrusje Ishull trafiku
RRETHROTULLIMI	Rrugë mesatarisht e ngarkuar, me 50 km/orë ose më shumë Rrugë kryesore mesatarisht e ngarkuar, rrugët parësore lokale, rrugë lokale Brenda dhe jashtë zonës së ndërtuar	Hierarki e rrugëve, intensitetet dhe kapaciteti i kërkuar Pista e pedalimit, korsi pedalimi ose trafik i përzier	Një-korsi ose korsi dy-she Përmasa e rrethrotullimit Pistat bypass-e të pedalimit Tunel pedalimi
KRYQËZIMI ME SEMAFOR (sistemet e kontrollit)	Rrugë të ngarkuara me rreth 50 km/orë ose më shumë	Kapaciteti i nevojshëm i rrjedhës së pedaluesve dhe koha e dëshiruar e	Rregull shenjues Zbulimi i pedaluesit

të trafikut)	Rrugë kryesore të ngarkuara	pritjes	Vijë-ndalesat e avancuara
	Brenda dhe jashtë zonës së ndërtuar		Korsitë e kthimit



Burimi i imazhit: T. Asperges, Fietsberaad,

3 Vend-qëndrimi i bëqikletës

Parkimi i bëqikletës historikisht mbetet një çështje dytësore. Tashmë e kuptojmë se parkimi dhe ruajtja janë po aq të rëndësishme sa një rrjet bëqiklete. Këtu, së pari do të shikojmë arsyet për një politikë të parkimit të bëqikletave, si dhe duhet të tentojmë të bëjmë dallimin mes parkimit afat-shkurtër dhe afat-gjatë. Pastaj do të konsiderojmë kërkesën për parkim në vendmbërritje dhe kërkesën për ruajtje, në ose afër shtëpive. Së fundmi, do të jepem disa të dhëna të shkurtra për parkimin dhe ruajtjen.

3.1 Përse duhet një politikë e parkimit të bëqikletës?

Një nga pikat kryesore të bëqikletës është se ajo mbetet një mjet i vogël dhe i lehtë, i përshtatshëm për të hipur dhe zbritur me lehtësi. Ju mund ta mbështetni atë kundrejt një muri ose ta lini të qëndrojë në këmbalecin e saj dhe nëse jeni të shqetësuar për një vjedhje të mundshme, mjafton vetëm t'a lidhni atë në kangjella, një shtyllë ndriçimi rrugore apo një tabelë sinjalistike. Pra, a kemi me të vërtetë nevojë për objektet e parkimit të bëqikletave?

